

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike sipas padisë së paditëses Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” sh.a nga Prishtina të cilën me autorizim e përfaqëson N.D kundër të paditurit S.B nga fshati K.Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson av.N.I nga Ferizaj, në çështjen juridike kthim borxhi, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më dt.24.12.2018, mori, kurse me dt.10.01.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesë padia e paditëses Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” sh.a nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri S.B nga fshati K.Ferizaj, që paditëses t’ia paguaj shumën prej 800 € (tetëqind euro) në emër të kthimit të borxhit, me kamat ligjore nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim e përmbarimit me dhunë, si e pabazuar.

II. DETYROHET paditësja që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej 104 € për përpilimin e përgjigjes në padi, si dhe 135 € për pjesëmarrjen në seancë, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Më datë 22.10.2018, paditësja Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A nga Prishtina në këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurit S.B për kthim borxhi.

Lidhur me këtë, gjykata ka caktuar seancën gjyqësorë më datë 24 dhjetor 2018, në të cilën I autorizuar i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke shtuar se nga provat e administruara është vërtetua baza juridike e kërkesë padisë, nuk është e vërtetë se i padituri ka pranuar kompensimin duke vepruar me mirëbesim pasi që i njëjti e din që se sistemi gjyqësor në Kosovë vepron në bazë të tri shkallshmerisë dhe vendimi Gjykatës Supreme gjithmonë e mbizotëron vendimin e një

gjykatë të shkallës më të ulët. Po ashtu të njëjtit përmes përfaqësuesit të tij iu është tërhequr vërejtja se nëse ka ndryshime i njëjti duhet të përgjigjet për ndryshime të mundshme, është e vërtetë se vullnetarisht e kanë bërë pagesën por kjo ka ndodhur vetëm për ti ikur shpenzimeve të përmbarimit mirëpo pas pranimi të vendimit të Gjykatës Supreme i cili e ka ndryshuar shumën kërkojmë nga i padituri që ta kthen shumën e tepërt që e ka marrur në këtë rast.

Ka kërkuar që të aprovohet kërkesë padia ashtu siç është precizuar me anë të parashtrës së si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës

E autorizuar e të paditurit në fjalën e saj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke shtuar se paditësja te paditurit i ka paguar shumën e gjykuar sipas aktgjykimit të gjykatës së parë të kësaj gjykate i cili aktgjykim ka qene i vërtetuar nga Gjykata e Apelit ne Prishtinë dhe menjëherë pas pranimi paditësja përmes telefonit e ka ftuar të autorizuarin e të paditurit që menjëherë te bëjë pagesën sipas këtij aktgjykimi në mënyrë që mos të shkoje në procedurë te përmbarimit, ashtu që pagesa të paditurit i është bërë menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkallës së parë me vetiniciativë të paditëses.

Paditësja pas ushtrimit te revizionit kundër aktgjykimit te shkallës se dyte ka mundur te kërkojë shtyrjen e pagese sipas këtij aktgjykimi deri sa te mos vendoset lidhur me revizionin e parashtruar.

Ka deklaruar se nuk është kontestuese se të paditurit i është bërë pagesa me vet iniciativën e paditësit pa kërkesën me shkrim të paditurit S.B por nuk ekziston detyrimi ligjor i të paditurit për kthimin e shumës së pranuar në bazë të vendimit gjyqësor të cilën shume e ka pranuar me mirëbesim nga e paditura e ky detyrim ligjor është parapare me nenin 199 te LMD-se i cili ligj është ne aplikim dhe ka qene ne aplikim ne momentin e pagesës.

Ne momentin kur ligjdhënësi e ka parapare këtë dispozite ka pasur njohuri qe Gjykata gjykojnë në dy shkallëshmeri ndërsa gjykatat Supreme vendosin vetëm me mjete te jashtëzakonshme.

Prandaj në këtë kontest padia e paditësit për kthimin e lartësisë e caktuar ne kërkesëpadi është e pa bazuar pikërisht sipas kësaj dispozite ligjore, i propozojë gjykatës që kërkesëpadi e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata, për këtë çështje nuk ka caktuar seancë përgaditore, por drejtpërdrejt ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, edhe pse në parim seancë përgaditore është e detyrueshme. Neni 401 i LPK-së-së, parasheh *“Seanca përgaditore është e detyrueshme, përveçse në rastet në të cilat gjykata.....nga shkakun e pandërlikueshmërisë së kontestit vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgaditore”*.

Gjykata për ta vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore bëri administrimin e këtyre provave :

- Padia C.nr.1024/18 e dt.22.10.2018
- Raporti i policisë me nr.2012-CFT252 e dt.09.04.2012
- Vendimi 31-14.2016 dt.20.06.2016
- Aktgjykimi i Gjykatës themelore në Ferizaj me nr.C.nr.643/12 e dt.05.01.2015
- Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit me nr.AC.nr.1329/15 dt.26.02.2018
- Aktgjykim i Gjykatës supreme të Kosovës me nr.REV.nr.176/18 dt.18.06.2018
- Përgjigje në padi dt.22.11.2018

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara një nga një dhe të gjitha s’bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata nga provat e administruara ka konstatuar se nuk ishte kontestuese se si pasojë e aksidentit të datës 09.06.2012 i padituri S.B ka pësuar lëndime të lehta trupore, dhe si pasojë e lëndimeve trupore ka paditur atëherë K.S’’Dukagjinin’’ për kompensim dëmi dhe sipas vendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.643/12 është kompensuar në shumën prej 3,500.00 €, aktgjykim i cili është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin me numër Ac.nr.1329/15.

Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se tash paditësja K.S''Dukagjini'' sh.a i ka paguar shumën e gjuar sipas Gjykatës së Apelit 3,500.00 € për dëmin, tani të paditurit S.B.

Nga provat e administruara Gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesë padia e paditësit është e pabazuar nga fakti se shumata e paguara të paditurit S.B nga paditësja janë shumata të caktuara pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.643/12 të datës 05.01.2015 i cili aktgjykim është vërtetuar në tersi me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1329/15 të datës 26.02.2018.

Gjykata bazën ligjore për refuzimin e kërkesëpadisë e bazoi nga dispozita e nenit 199 të LMD pika 1 e cila parasheh *''Nuk mund të kërkohet kthimi i shumave të kompensuar pa bazë në emër të shpërblimit të dëmit për shkak të lëndimit fizik, dëmtimit të shëndetit ose vdekjes, në rast se pagesa i është bërë marrësit që ka vepruar në mirëbesim, ndërsa pika 2 e po këtij neni thekson ''Si shumata e paguar pa bazë llogaritet edhe pagesa mbi bazën e një vendimi gjyqësor që me vonë është ndryshuar ose prishur.*

Gjykata gjatë analizimit të shkresave të lëndës vërtetoi se tani i padituri S.B shumata e pranuar në emër të dëmshpërblimit të dëmit i ka marrur me mirëbesim, ai nuk ka e ka ditur dhe sipas rrethanave të rastit nuk ka mundur ta dijë se shumata i janë paguar pa bazë ligjore. Nga vet fakti se i padituri ka pësuar lëndim, i është dëmtuar shëndeti dhe ai ka pësuar dëm material ose dëm jomaterial, nënkupton se ai ka pritur që ti kompensohet dëmi i shkaktuar dhe ka konsideruar se e ka të drejtën e një shpërblimi të tillë të dëmit. Pra në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për gjendjen e vetëdijes së personit që ka pranuar pa bazë ligjore shumën e të hollave në emër të shpërblimit të dëmit, ashtu që në këto raste nuk është me ndikim gjendja e vetëdijes së personit që ka paguar këto shumata.

Andaj me qenë se nuk është provuar me asnjë provë se i padituri është pasuruar pa bazë juridike gjykata ka vendosur që kërkesë padia e paditëses është e pa bazuar, për arsyet e lart cekura.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh gjithnjë edhe pretendimet e tjera të paditëses në lidhje me këtë çështje kontestimore se duhet të aprovohet kërkesë padia e saj

por nga provat të cilat janë administruara nuk është provuar se ka pasur bazë për të vendosur ndryshe, për dallim të asaj që ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar paditësen që t'ia kompensoj të shpenzimet gjyqësore të paditurit shumën prej 104.00 € për përpilim të përgjigjes në padi, si dhe për një seancë gjyqësore shumën prej 135 €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1024/18 më dt.10.01.2019

Gjyqtarja
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.